

**VENDIM**  
**Nr. 544, datë 19.9.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 408, DATË 8.5.2013, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR DËMSPËRBLIMIN PËR KAFSHËT E ELIMINUARA”, TË**  
**NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 49, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 408, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në të gjithë tekstin e vendimit, emërtimi “Struktura përgjegjëse për veterinarinë në institucionin përkatës” zëvendësohet me “Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve (ARSHVMB)”.

2. Pika 1.1. ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1.1 Pronarët e kafshëve, që kanë ngordhur si pasojë e prekjes nga sëmundja e Dermatozës Nodulare të Gjedhit, gjatë viteve 2016 e 2017, dhe nuk janë dëmshpërblyer fizikisht me kafshë, do të shpërblehen në masën e vlerës së dëmit, sipas pikës 13, të këtij vendimi.”.

3. Në pikën 6, fjalët “... në shërbimin veterinar të qeverisjes vendore ...” zëvendësohen me “.... në strukturën përgjegjëse të njërive të vetëqeverisjes vendore ...”.

4. Në pikën 9, fjalia “Ky komision kryen edhe vlerësimin e dokumentacionit në rastin e dëmshpërblimit fizikisht me kafshë” shfuqizohet.

5. Në pikën 13, fjalia “Dëmshpërblimi fizik me kafshë do të bëhet në përputhje me procedurat e prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi” shfuqizohet.

6. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“14. Titullari i ARSHVMB-së nxjerr aktin për dëmshpërblimin e pronarit të kafshës, që duhet të zbatohet nga ARSHVMB-ja brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dalja e aktit të dëmshpërblimit.”.

7. Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“17. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve dhe strukturat përgjegjëse të njërive të vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**